

VENDIM
Nr. 907, datë 11.11.2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 11, DATË 14.1.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2015 NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 11, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1 bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

i) Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe zëvendësohet me “2 260 veta”.

ii) Pas fjalëve “... pas lidhjes nr. 1 ...” shtohen “... dhe lidhjes nr. 2, “Mbi punësimin e 200 praktikantëve në institucionet buxhetore”...”.

b) Në pikën 2, pas fjalëve “... në Ministrinë e Financave ...” shtohen “... dhe praktikantët e përzgjedhur të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe institucionet e tjera publike ...”.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për institucionet e përmendura në këtë vendim, për vitin 2015.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 2

MBI PUNËSIMIN E 200 PRAKTIKANTËVE NË INSTITUCIONET BUXHETORE

Emri i institucionit	Numri i punonjësve	Emërtesa, kategoria	Kohëzgjatja ditore	Periudha kohore
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	30	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Punëve të Brendshme	6	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Energjetikës dhe Industrisë	18	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Financave	12	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Arsimit dhe Sportit	9	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Kulturës	15	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	9	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Mbrojtjes	5	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Zhvillimit Urban	24	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Mjedisit	6	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Kryeministria	16	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	16	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Shëndetësisë	9	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Punëve të Jashtme	3	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	9	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor

Ministria e Integritetit Evropian	3	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
Ministria e Drejtësisë	10	specialist IV-b	8 orë	nëntor-dhjetor
TOTAL	200			